



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 15.10.2025
Numër Protokolli: 7037/2025

A.nr.1628/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1628/2025, të datës 27.08.2025, të parashtruar nga ankuesi R.E, kundër organit të punësimit: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet si e pa bazuar** ankesa me numër A.nr.1628/2025, e datës 27.08.2025, e parashtruar nga ankuesi R.E.
- II. **Mbetet** në fuqi Akt Emërimi i datës 24.07.2025, për pozitën e punës Administrator i Gjykatës Themelore në Gjakovë.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil R.E, (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), përmes postës më datë 22.08.2025 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 27.08.2025, dhe protokolluar me numër 5723/2025, kundër Akt Emërimit të datës 24.07.2025, të lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, lidhur me caktimin e pozitës së tij të punës me mandat katër (4) vjeçar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 09.09.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariatit i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: SKGJK), ndërsa ky i fundit, më datë 18.09.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5723/2025 të datës 27.08.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Akt emërimit me numër protokolli 05/167 të datës 07.04.2014; Kontratën e punës me numër protokolli 01/1094 të datës 29.07.2022; Vendimin A.nr.1066/2022 të datës 26.01.2023, të KPMSHCK-së; Akt emërimit me numër protokolli 03/1829 të datës 02.08.2024; Akt emërimit të datës 24.07.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë 08.09.2025; Përgjigjen në ankesë e

datës 29.09.2025; Akt Emërimit me numër Reference: DS-512/2024, të datës 01.07.2024; Përgjigjen në ankesën e datës 22.08.2025, nga Departamenti për Çështje Ligjore në SKGJK për ankuesin; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 09.09.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 18.09.2025; E-mailin e datës 24.07.2025.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesit është e **pabazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokolli 03/1829, të datës 02.08.2024, mbanë pozitën e Administratorit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, në kuadër të SKGJK.

Tutje, pas miratimit të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, dhe publikimit të Aktgjykimit për rastet nr. KO222/24 dhe KO224/24 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së këtij ligji, organi përkatës i punësimit, me datë 24.07.2025 i ka lëshuar ankuesit Akt emërimit për pozitën e njëjtë, atë të Administratorit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, me mandat katër (4) vjeçar duke filluar nga data 17.06.2025 deri më 16.06.2029.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se me akt emërimit të datës 22.07.2025, ka ndryshuar marrëdhëniet e punës respektivisht është cenuar siguria e marrëdhënies së punës e fituar sipas Akt emërimit pa mandat të datës 01.08.2024, ngase përcaktimin i pozitave udhëheqëse si pozitë me mandat nga ato të karrierës cenon qëndrueshmërinë e shërbimit civil dhe pritshmërit legjitime dhe të arsyeshme. Andaj, kërkon shqyrtimin e ligjshmërisë së Akt emërimit të datës 24.07.2025 dhe krahasimin e tij me vendimin paraprak të vlefshëm, konstatimin e cenimit të së drejtës së fitues dhe të sigurisë juridike në rastin konkret, si dhe anulimin ose rishikimin e akt emërimit të ri, duke ruajtur statusin e mëparshëm pa afat, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e kësaj çështje juridike-administrative fillimisht ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, respektivisht nenin 2 paragrafi 3, ku përcaktohet: *3. Për nëpunësit/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për aq sa nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë*”, nenit 6 paragrafi 4 ku përcaktohet: *Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë*, e për rrjedhojë ky ligj zbatohet edhe për nëpunësit e SKGJK-së për aq sa nuk cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative, dhe po ashtu të punësuar e administratës në kuadër të SKGJK-së kanë statusin e nëpunësit civil me status të veçantë. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh faktin se Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka miratuar aktet juridike për rregullimin e marrëdhënies së punës për nëpunësit e administratës në kuadër të SKGJK-së, aplikohen aktet e tyre të brendshme, mirëpo sa i përket pozitave të kategorisë së mesme drejtuese dhe ulët drejtuese ky institucion nuk ka ndonjë akt juridik të miratuar përmes të cilit do të bëhet rregullimi i marrëdhënies së tyre të punës me akt të veçantë, atëherë aplikohen dispozitat përkatëse të legjislacionit përkatës për zyrtarët publikë.

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e kësaj çështje juridike-administrative, konstaton se Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka miratuar Ligjin Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i cili me nenin 18 paragrafi 3, ka përcaktuar: *3. Nëpunësit civil të emëruar në pozita e kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese para hyrjes në fuqi të ligjit bazik konsiderohet se*

fillojnë mandatin e parë me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Kolegji i Këshillit, konstaton se ky ligj i është nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe kjo gjykatë sipas Aktgjykimit për rastet nr. KO222/24 dhe KO224/24, ka konstatuar se tërësia e këtij ligji nuk është në kundërshtim me parimet kushtetuese, ndërsa lidhur me nenin 18 paragrafi 3 të këtij ligji që lidhet me pozitat e kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese të cilat janë përcaktuar si pozita me mandat, Kolegji mori për bazë pikat e Aktgjykimit për rastet nr. KO222/24 dhe KO224/24 të datës 28.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, gjegjësin, pikën 153. Bazuar në vlerësimin dhe konstatimin si më lart, Gjykata konsideron se paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 18 (Dispozitat kalimtare) të Ligjit të kontestuar ua garantojnë nëpunësve civilë të nivelit të mesëm dhe të ulët drejtues, të cilët aktualisht mbajnë pozita me mandat të pacaktuar, pavarësisht nëse në momentin e emërimit të tyre në pozita me mandat të pacaktuar, kanë qenë ose jo pjesë e shërbimit civil, minimalisht një mandat 4 (katër) vjeçar që fillon nga hyrja në fuqi e këtij ligji, me mundësi vazhdimi edhe të një mandati tjetër 4 (katër) vjeçar, me kusht që të njëjtit e arrijnë vlerësimin “arrin pritshmëritë”. Në rast të (i) mosvazhdimit të mandatit të parë kur nuk arrijnë vlerësimin “arrin pritshmëritë”; ose (ii) mospërzgjedhjes pas përfundimit të mandatit të dytë; ose (iii) moskonkurrimit për pozitën që e kanë mbajtur, Ligji i kontestuar ua garanton marrëdhënien e punës nëpunësve civilë të kësaj kategorie duke i sistemuar në një pozitë të lirë të kategorisë profesionale. Në leximin e përbashkët të dispozitave relevante të Ligjit bazik dhe atij të kontestuar, Gjykata, rithekson se nëpunësit civilë të afektuar nga ky ligj ruajnë marrëdhënien e punës në shërbimin civil pa përfshirë në listën e pritjes sipas nenit 67 (Lista e pritjes) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, të plotësuar dhe ndryshuar përmes nenit 12 të Ligjit të kontestuar. 154. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton që paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar janë në pajtueshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. 155. Bazuar në konstatimin e Gjykatës që paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar nuk janë në kundërshtim me të drejtat pronësore të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, Gjykata thekson se përcaktimet përmes këtyre dispozitave, nuk bien në kundërshtim me të gjeturat e Aktgjykimit të saj në rastet KO216/22 dhe KO220/22, ndërsa në dispozitiv të këtij aktgjykimi respektivisht pikën II është vendosur: II. TË KONSTATOJË, që paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 18 (Dispozitat kalimtare) të Ligjit Nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nuk janë në kundërshtim me nenin 46 [Mbrotja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me paragrafin 1 të nenin 1 (Mbrotja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Andaj duke qenë se sipas nenit 18 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nëpunësit civil të emëruar në pozita e kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese para hyrjes në fuqi të ligjit bazik konsiderohet se fillojnë mandatin e parë me hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe këto dispozita janë shpallur në pajtim me parimet kushtetuese të Republikës së Kosovës, sipas aktgjykimit të cekur më lartë, atëherë edhe Akt emërimi i datës 24.07.2025, i kontestuar nga ankuesi është në pajtim me nenin 18 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Aktgjykimin për rastet nr. KO222/24 dhe KO224/24 të datës 28.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, kështu që pretendimet e ankuesit për kthim të mandatit sipas akt emërimit paraprak janë të pabazuara ligjërisht.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1628/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesi R.E;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në SKGJK; dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.